



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 25 – 6131 – 1-2-1/C1104
14 Nr. 924/25
Dt. 28.08.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **Migros - 2 “sh.p.k.** me seli në **Vushtrri**, me **ARBK : 810017310**, të cilën e përfaqëson **z. Sami Plakolli**, në tekstin e mëtejshëm: **FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për furnizime, si vijon: **Furnizimi me material pedagogjik**, me numër prokurimi :

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	61	3	1	1	2	1
Nr. i brendshëm	644	2	5	0	3	9	1	2	1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me material pedagogjik (ditar shkollor dhe libër regjistri të ndryshëm) në pajtim me Aneksin 1 dhe Listës së përshkrimit të artikujve, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : VU644-25-6131-121 dhe nr. të brendshëm : VU644-25-039-121**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.**
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë : **shkollat sipas Regjistrit të Njësisë Kërkuese të A.K.. Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës të A.K.**
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë **DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).**
- 2.4 Në rast se Furnizuesi dështon në përmbushjen me kohë të detyrimit si në paragrafin paraprak të këtij neni, Blerësi mbanë të drejtën që për secilën ditë në vonesë të Furnizuesit, të zbatoi penale me 0,25% të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës, në çdo ditë të vonesës.

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 10,765.00 € (dhjetmijshatatqindgjashtdejetepesë/00€).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës, respektivisht pas pranimit të mallit nga ana e Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna Vushtrri

Për: " Migros -2 "sh.p.k. – Vushtrri

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Sami Plakolli
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2025	Data:	28.08.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.